



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Kosovës
Komisioni për Integritime Evropiane
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 17. 03. 2008
Ndërtesa e Kuvendit, ora 11:00, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Dzezair Murati, Hydajet Hyseni, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova e Branislav Grbic ndërsa munguan: Lutfi Haziri dhe Edita Tahiri.

Në mbledhje sipas ftesës, mori pjesë edhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Minire Hasani, Adelina Demolli dhe Manush Krasniqi.

Sabiha Shala – Agjencioni për Integrim Evropian ZKM

Floreta Kabashi– AIE-ZKM

Avni Zuka-NDI

Petrit Hysa e Lejla Selimi-OSBE

Hana Bajrami-ZKM

Agron Demi-GAP

Nexhat Shatri-Zyra e Presidentit

Blerim Vela-OMIK

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 3. Njoftim nga zëvendëskryeministri z.H. Kuçi për progresin e institucioneve të Kosovës, drejt integritimeve evropiane,**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratohet rendi i ditës.**
- 2. Miratohen procesverbalet nga mbledhja e kaluar.**

3. Njoftim nga zëvendëskryeministri z. H. Kuçi për progresin e institucioneve të Kosovës, drejt integritimeve evropiane

Zylfije Hundozi lidhur progresin e institucioneve të Kosovës drejt integritimeve evropiane, fjalën ia dha zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi.

Hajredin Kuçi fillimisht shprehu kënaqësi për ftesën që i është bërë në mënyrë që të njoftoj Komisionin lidhur me proceset e integritimeve evropiane, për të cilën tha se janë prioritet i Qeverisë së Kosovës dhe çështje e politikës nacionale. Bashkimi Evropian që nga viti 2002 i ka dhënë mundësi Kosovës përmes Mekanizimit Përcjellës të Stabilizim Asociimit (MPSA), që të jetë në hap me vendet e rajonit. Në vitin 2006 është themeluar Agjencioni për Integritime Evropiane, i cili ka funksionin ndoshta të përafërt me një ministri. Në vazhdim tha se jemi në fazën e shqyrtimit, se si do të trajtojmë integritimet evropiane. Në vendet e rajonit ka vende që kanë ministri të veçantë për integritime evropiane, ka vende që kanë agjencion ashtu çfarë e kemi edhe ne dhe ka vende që ky dikaster udhëhiqet nga njëri nga zëvendës kryeministrat e vendit. Agjencioni për Integritime Evropiane, pranë zyrës së kryeministrit përbëhet nga katër drejtori të cilat mbulojnë fushat, e menaxhimit të Procesit të Stabilizim Asociimit, përafrimin e legjislacionit dhe koordinimin e përkthimit të *acquis* komunitair, koordinimin e asistencës së BE-së dhe fushën e komunikimit, informimit dhe trajnimit.

Ne kemi pas për qëllim që të plotësojmë tri kritere që kërkohen nga BE, e që janë kriteri juridikë, ekonomik dhe politik. Sa i përket kriterit të parë të përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së, Kuvendi i Kosovës ka bërë një punë të mirë duke bërë përpjekje që ligjet e nxjerra të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së.

Në kuptimin e ndërtimit të stabilitetit politik, Qeveria e Kosovës konsideron që Kosova ka një stabilitet politik edhe në kuptimin e mbështetjes nga bashkësia ndërkombëtare, por ndoshta ka ndonjë problem me pjesën e integritimit të ndonjë komuniteti në Kosovë.

Në planin ekonomik, tha se ne jemi të orientuar të bëjmë një orientim të plotë në ekonominë e tregut në këtë drejtim Qeveria e Kosovës, mendon se hyrja në BE nuk do të jetë rezultat i mëshirës që ka ndokush ndaj nesh, por se Kosova do të jetë shtet konkurrent. Integritimi i Kosovës në BE duhet të jetë në hap me vendet e rajonit dhe të mos mbesim prapa tyre, sepse do të krijoheshin probleme për ne. Si problem i parë do të izolohej qarkullimi i individëve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit dhe si problem i dytë i cili është problem politik, është integritimi në BE.

Në këtë drejtim ne kemi pas edhe PVPE –an, ku Komisioni Evropian dhe Qeveria e Kosovës, organizojnë takime të nivelit të lartë. Gjerë më tani janë mbajtur 13 takime me qëllim të MSA, por kësaj radhe plani ndoshta është më i theksuar në institucionin e para-anëtarësimit. Ky institucion është nënshkruar në vitin 2006, ndërsa ne për vitin 2008 kemi ndarë një shumë të buxhetit prej 124 milion euro .

Menaxhimi i këtij fondi nuk bëhet nga Qeveria e Kosovës por në formë të centralizuar bëhet nga Komisioni Evropian. Një skemë të veçantë që i kushtojmë rëndësi, është ndarja e bursave për profesionistë të rinj për studime në nivelin master në universitete evropiane .

Gjendja në integritimet evropiane momentalisht është më shumë synim politik, vullneti politik dhe infrastruktura legale ekziston në Qeverinë e Kosovës që ta ngrisim këtë kapacitet.

Qeveria e Kosovës konsideron se ky është një proces i gjatë dhe jo shumë i lehtë, por i arritshëm dhe se në vitin 2011 apo 2012, do të nënshkruajmë Marrëveshjen për Stabilizim Asociim.

Sabri Hamiti tha se pikat themelore të orientimeve qeveritare drejt integritimeve evropiane, që i tha zëvendëskryeministri janë një vazhdimësi e angazhimit të qeverisë paraprake, sipas programit përcjellës. Çështja e integritimeve evropiane është një vullnet politik i yni, i cili duhet të bëhet vepër, përmes masave dhe kritereve zhvillimore tek ne. Në vazhdim tha se, është koha që Qeveria jonë me mekanizmat e saja të fillojë një bashkëbisedim me Brukselin, për liberalizim të vizave për kategoritë e caktuara, siç janë ekspertët, studentët, biznesmenët dhe kategoritë e tjera, të cilat e kanë të nevojshme të qarkullojnë e të komunikojnë, më lehtë me botën e jashtme dhe vendet e BE-së.

Naser Rugova tha se integrimi evropian është orientim politik i institucioneve të Kosovës, që ka tri objektiva të përgjithshme, atë politike, ekonomike dhe standardet evropiane.

Objektivat politike janë çështje e institucioneve qendrore, por ne duhet të lëshohemi edhe në bazë, në komuna që koncepti i integritimit evropian të jetë orientim i shoqërisë Kosovare.

Objektivat ekonomike do të varen shumë edhe nga politikat e qeverisë, nga çështja e privatizimit, e ekonomisë konkurrenente e tjera.

Objektivi i tretë, standardet evropiane kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut për komunitete, në këtë drejtim ne duhet që bashkërisht të organizojmë debate, të bisedojmë edhe me përfaqësuesit e BE-së, që janë këtu dhe të ju tregojmë se Kosova ka qasje shumë serioze ndaj këtij procesi dhe se po tenton të ndërtoj një shtet normal dhe demokratik. Sa i përket çështjes së ngritjes së ekspertëve të ri, që do të specializohen në lëmi të ndryshme të këtij problemi, tha se është çështje me të cilën është ballafaquar tërë Ballkani Perëndimor, dhe kualifikim i njerëzve është shumë i nevojshëm sidomos në aspektin e legjislativitetit.

Hydajet Hyseni tha se, është mirë që në fillim po vendosen raporte adekuate në mes të legjislativitetit dhe ekzekutivitetit, sepse është punë që nënkupton edhe një harmonizim në këto dy shtylla. Në vazhdim tha se procesi i integritimit evropian, duhet të shikohet nga procesi i evropizimit që është proces historik, substancial shoqëror edhe i brendshëm i shoqërisë, që duhet të jetë një orientim dhe tjetra nga procesi i integritimit institucional që është pastaj edhe kurorëzim i këtij procesi. Komisioni ynë, tha se duhet të mbështetet me staf plotësues profesional. Njëkohësisht tha se duhet përsheptuar puna me funksionalizimin të Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe të rrjetit diplomatik pa të cilat nuk mund të ketë proces të mirëfilltë të integritimit evropian. Mendon se duhet të krijohen mundësit materiale financiare për trupat e Kuvendit, me qëllim të bashkëpunimit me kuvendet e tjera, si mënyrë e ndikimit parlamentar në procesin e integritimeve. Po ashtu tha se është e nevojshme pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme ndërkombëtare, në të cilat ne ndonjëherë kemi qenë të pranishëm, por jo në mënyrë institucionale.

Dzezair Murati përshëndeti praninë e zëvendëskryeministrit për informacionet konkrete e optimiste lidhur me integritimet evropiane. Në vazhdim tha se i përfaqësojë komunitetet që kanë qëndrim konstruktiv të realitetit në Kosovë, dhe bëjnë përpjekje që në të vërtetë të jenë pjesë e kësaj shoqërie.

Në proceset të cilat janë para nesh tha se, nuk duhet të harrojmë komunitetet të cilat janë angazhuar dhe kanë kontribuar për shtetin e tyre.

Branislav Grbic në mes tjerash tha se pjesëmarrja ime në këtë Komision dhe angazhimi im paraprak në institucionet e Kosovës, është në interes të komunitetit tim dhe në interes të proceseve të integritimit.

Mendoj se ekziston dëshira e të gjithëve që të ndërtojmë një qëndrim të përbashkët rreth integriteteve evropiane, përmes të cilit do të zgjidheshin të gjitha problemet e tjera të cilat do të mund të paraqiteshin me kalimin e kohës.

Integrimi paraqet një shkallë të vetëdijesimit të popullit i cili dëshiron të integrohet në proceset evropiane, por varet nga ne sa jemi të gatshëm për këtë proces.

Në vazhdim tha se ne kemi përfaqësues të komunitetit me kualitete të larta, të cilët duan të integrohen dhe të japin kontributin e tyre në këtë proces, dhe unë si anëtarë i këtij Komisioni do të jap kontributin tim .

Fatmir Rexhepi tha se po e shoh këtë informim të sotshëm si të domosdoshëm, dhe njëkohësisht një bashkëpunim të Qeverisë dhe të Parlamentit në harmonizimin e politikave, që kanë të bëjnë me përmbushjen e standardeve në fazat drejt integriteteve. Në këtë drejtim tha se është mirë të debatohet, për ti parë kapacitetet të cilat i kemi dhe progresin e domosdoshëm, që ne të mos vonohemi në këtë rrugëtim. Ne bashkërisht na presin sfida në këtë drejtim, por është një dëshirë e madhe e jona, e mbi të gjitha politika e Qeverisë dhe e Kuvendit, me ndihmën e bashkësisë evropiane, për përmbushjen e fazave më të domosdoshme për standarde, dhe ecje drejt integriteteve.

Zylfije Hundozi pyeti se nga mjetet e parapara përmes IPA-së për këtë vit, a është paraparë aktiviteti i Komisionit për integritete evropiane.

Hajredin Kuçi lidhur me liberalizimin e vizave, tha se kemi pas diskutime të theksuara në këtë drejtim, por është menduar se para se të fitohet numri i madh i shteteve anëtare të BE-së, të mos bëhet një kërkesë e tillë sepse mund të refuzohet. Në këtë drejtim kemi menduar për tri kategori të shtetasve, për studentët, studiuesit dhe për punëtorët sezonal, ndërsa në të ardhmen do të kërkojmë edhe për kategoritë e tjera.

Sa i përket bashkëpunimit atë e shohim në tri rrafshë, në rrafshin vendor, nacional dhe shtetëror dhe i kemi identifikuar fushat, dhe kemi identifikuar edhe stafin. Krijimi i Ministrisë së Jashtme dhe rrjeti diplomatik tha se, do të na lehtësoj punën dhe mendojmë se shumë shpejtë do ta krijojmë.

Jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me Komisionin dhe kemi kërkuar nga shefi i AEI, që të merr pjesë në mënyrë permanente në mbledhjet e Komisionit tuaj dhe t'ju ofrojë raportet për punën që bënë Agjencioni.

4. Të ndryshme

Zylfije Hundozi e njoftoj Komisionin se e ka bërë një kërkesë për sigurimin e një eksperti, për nevoja të Komisionit i cili do të financohet nga Komisioni Evropian.

Në vazhdim e njoftoi Komisionin se Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, propozon që ta mbajë një takim pune të Komisionit më dt. 14 prill, ku do të merrte pjesë edhe Neven Mimica kryetar i Komisionit për Integritete Evropiane nga Kroacia, që të na njoftoj lidhur me përvojën e Kroacisë gjatë rrugës së tyre drejt integriteteve evropiane.

Lidhur me këtë propozim Komisioni nxori këtë

P e r f u n d i m

Komisioni përkrahë propozimin e Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile, për mbajtjen e një takimi të punës më dt. 14 prill 2008 me pjesëmarrjen e z.Neven Mimica, kryetar i Komisionit për Integritete Evropiane nga Kroacia .

Përfaqësuesi i NDI, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit me Komisionit, propozon që të organizoj një vizitë për Komisionin në ndonjërin nga vendet e rajonit, me qëllim të njoftimit me përvojat e tyre, drejt integritimeve evropiane.

Pas diskutimit të deputetëve lidhur me këtë propozim, Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Me qëllim të njoftimit me përvojat drejt integritimeve evropiane, Komisioni vendosi që të bëjë një vizitë pune në Ministrinë për integritime evropiane dhe Komisionin për integritime evropiane të Republikës së Shqipërisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00min.

Procesmbajtësi
Minire Hasani

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi